

VENDIM
Nr. 668, datë 10.10.2019

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 645, DATË
1.10.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NGRITJEN DHE MËNYRËN E
FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË ÇMIMIT TË BARNAVE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 38, të ligjit nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 645, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Mbjtësit e autorizimit të tregtimit të barit në Shqipëri ose përfaqësuesi ligjor i autorizuar prej tij, brenda datës 31 tetor të çdo viti, deklarojnë me shkresë, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi, në zarf të mbyllur, pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, çmimet “CIF” në euro ose dollarë, për barnat e importit dhe çmimet “EXW” (*ex-work*) në lekë, për barnat e fabrikuar në vend, kur barnat janë të pajisura me autorizim për tregtim. Dorëzimi i çdo zarfi të mbyllur me deklarin e çmimeve bëhet në protokollin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe shoqërohet me nënshkrimin e personit të autorizuar nga shoqëria për këtë veprim dhe të punonjësit të protokollit, i cili pranon dokumentacionin. Çdo zarf i ardhur në ministri regjistrohet në një regjistër të veçantë, me numrin rendor përkatës dhe datën e marrjes së tij në dorëzim.

Në rastet kur bari është në proces për t’u pajisur me autorizim për tregtim ose proces rinovimi të autorizimit për tregtim, mbajtësi i autorizimit për tregtim ose përfaqësuesi i tij ligjor i autorizuar prej tij kanë të drejtë të bëjnë deklarin të çmimit të barit por komisioni miraton çmimin e barit, pasi ai është pajisur me autorizimin për tregtim.”.

2. Kudo në vendim, pas fjalëve “... mbajtësit të autorizimit për tregtim ...” shtohen fjalët “... ose përfaqësuesi i tij ligjor i autorizuar prej tij ...”.

3. Në pikën 8 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të fjalisë së parë shtohen fjalët “... ose deklarohen pas datës 31 tetor të vitit aktual ...”.

b) Në fjalinë e dytë, fjalët “... bëhet brenda 30 ditëve ...” zëvendësohen me “... bëhet brenda 60 ditëve ...”.

4. Pika 15 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“15. Barnat, për të cilat nuk është deklaruar çmim, brenda datës 31 tetor të vitit aktual, humbasin të drejtën për t’u përfshirë në listën e barnave të rimbursueshme për vitin pasardhës. Barnat të cilat janë në proces të pajisjes me autorizim ose rinovim autorizimi për tregtim dhe kanë deklaruar çmim brenda datës 31 tetor të vitit aktual, do të lejohen të aplikojnë për t’u përfshirë në listën e barnave të rimbursueshme, nëse bari pajiset me autorizim për tregtim deri në momentin e fillimit të procedurës së rishikimit të listës së barnave të rimbursueshme nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.”.

5. Pika 17 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“17. Struktura përgjegjëse në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, brenda datës 31 dhjetor të çdo viti, bën shpalljen në faqen zyrtare të ministrisë, të listës së përgjithshme me çmimet “CIF/EXW”, të miratuar nga komisioni. Kjo listë dërgohet pranë Agjencisë Kombëtare

për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Komisionet teknike pranë Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor negociojnë çmimet “CIF/EXW”, të miratuara nga Komisioni i Çmimit të Barnave, për të gjitha barnat ekzistuese dhe ato të reja, të propozuara për listën e listën e barnave të rimbursueshme, përpara hartimit të listës së barnave të rimbursueshme.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe